



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: **Shoqëria “Kadra” sh.p.k**

Adresa: Tirane Kamez LAKNAS Rruga Nene Tereza, Banese Private me Nr.Pasurie
180/29, Zona Kadastrale 2372

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”/Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik për secilin lot ku te gjitha kushtet jane te përcaktuara, me objekt: **“Blerje artikuj ushqimorë për Konviktet e Shkollave të Mesme për vitin 2020”**, Fondi limit /Vlera e pritshme e kontratës **13.986.704 (trembëdhjetëmilion e nëntëqind e tetëdhjete e gjashtëmijë e shtatëqind e katër)** lekë pa tvsh- *Nr. Ref 44283-11-20-2019*

Numri i referencës së procedurës /lotit të dytë **“Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme”**, Nr. REF-44292-11-20-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

“Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme”, Tirane.

Artikujt dhe sasia e parashikuar:

Nr.	Artikulli	Njësia	Sasia e pritshme
	Loti dyte		
1	ÇAJ MALI	kg	54
2	FASULE	kg	1000
3	SODË BUKE	kg	10
4	SHEQER	kg	1500
5	KRIPË	kg	1000
6	LIMONTOZ	kg	10
7	MAKARONA	kg	5000
8	VAJ LULEDIELLI	litra	2000
9	VAJ ULLIRI	litra	100
10	MIELL	kg	1000
11	NIESHTE	kg	200

12	ORIZ	kg	5300
13	PIPER KUQ+ZI	kg	50
14	SALCË	kg	1000
15	REÇEL	kg	1300
16	RIGON	kg	9
17	UTHULL	litra	300
	Shuma		

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 366 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) ditë nga data e nënshkrimit e marrëveshjes kuadër.

Fondi limit për lotin e dytë : “Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme”, me fond limit/ vlere te pritshme te kontrates **2.558.018 (dymilion e pesëqind e pesëdhjetë e tetëmijë e tetëmbëdhjetë) lekë pa tvsh. Shumatorja e çmimeve për njësi: 5325.5 (pesëmijë e treqind e njëzet e pesë presje pesë) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit:Buxheti i Shtetit dhe buxheti i Bashkisë Tiranë.

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike *Nr:47, date 25.11.2019*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1- Operatori ekonomik “ **Erdis ” sh.p.k** **NUIS**
K71804011J

Vlera e ofertës = **2.220.450 (dymilion e dyqind e njëzetmijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.**

2- Operatori ekonomik “ **Dogel ” sh.p.k** **NUIS K59418208E**

Vlera e ofertës = **1.796.700 (njëmilion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e shtatëqind) lekë pa TVSH.**

3- Operatori ekonomik “**Gerti 1987” shpk** **NUIS**
L27606201D

Vlera e ofertës = **1.896.500 (njëmilion e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind)lekë pa TVSH.**

4- Operatori ekonomik “**Kadra ” sh.p.k** **NUIS**
K31321008J

Vlera e ofertës = **1.968.300 (njëmilion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e treqind) lekë pa TVSH.**

5- Operatori ekonomik "Nelsa" shpk

NUIS J71601012S

Vlera e ofertës = 2.195.700 (dymilion e njëqind e nëntëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind) lekë pa TVSH.

6- Operatori ekonomik "Dajti Park 2007" shpk

NUIS K11507003S

Vlera e ofertës = 2.134.500 (dymilion e njëqind e tridhjetë e katërmijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

7- Operatori ekonomik "4 S" sh.p.k

NUIS L64425401K

Vlera e ofertës = 2.526.090 (dymilion e pesëqind e njëzet e gjashtëmijë e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Operatori ekonomik "Erdis" shpk

NUIS K71804011J

2. Operatori ekonomik "Dogel" shpk

NUIS K59418208E

3. Operatori ekonomik "Gerti-1987" shpk

NUIS L27606201D

4. Operatori ekonomik "Dajti Park 2007" shpk
K11507003S

NUIS

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik "Erdis" shpk

NUIS K71804011J

1.1 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, pika 2.3.2 e kapaciteti teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

"Operatori Ekonomik duhet të ketë ambjente të përshtatshme për tregëtimin dhe magazinimin e mallrave objekt prokurimi, në pronësi (vërtetuar me akti i pronësisë kopje e noterizuar) ose në përdorim, sipas kontratës përkatëse noteriale shoqëruar me :

➤ *Leje Higjeno-Sanitare*

➤ *Çertifikatë dezinfektimi 3D"*

Në plotësim të këtij kriteri çertifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur nga shoqëria Erdis shpk është e lëshuar më datë 01.04.2019 dhe përsëritja e trajtimit duhej bërë në 01.07.2019 pra operatori ekonomik nuk ka vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur që ky proces është kryer nga operatori ekonomik në datën 01.07.2019. Çertifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur në dokumentat e tenderit nuk është e vlefshme në datën e hapjes së procedurës duke mos plotësuar pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim kapaciteti teknik.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit

ekonomik “Erdis” shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Dogel” shpk

NUIS K59418208E

2.1 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, pika 2.3.4 e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:

Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar te ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.”

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Dogel” shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “Dogel” shpk nuk ka paraqitur liçencën e kategorisë II.1, Nënkategoria II.1.A.1 duke mos plotësuar pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

2.2 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, pika 2.3.3 e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

Operatori Ekonomik duhet të ketë, Mjet transporti ATP, në pronësi ose në përdorim, sipas kontratës noteriale, të vërtetuar me:

- leje qarkullimi,
- siguracion,
- **taksat e mjetit,**
- leje e transportit që lëshohet nga Bashkia,
- kontroll i mjetit,
- leje higjeno-sanitare,
- certifikate pronësie.

(dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi)

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur mjetin me targa AA 438 EY për të cilin në dokumentacionin shoqëruar nuk ka paraqitur pagesën për taksat e mjetit sikundër kërkuar në dokumentat e tenderit duke mos plotësuar pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Dogel” shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të**

pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “Gerti-1987” shpk

NUIS L27606201D

3.1 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.4** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:

Liçencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.”

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Gerti-1987” shpk konstatohet se ne përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “Gerti-1987” shpk nuk ka paraqitur liçencën e kategorisë II.1, Nënkategoria II.1.A.1 duke mos plotësuar pikën 2.3.4 të kritereve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

3.2 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, pika **2.3.3** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“Operatori Ekonomik duhet të ketë, Mjet transporti ATP, në pronësi ose në përdorim, sipas kontratës noteriale, të vërtetuar me:

- *leje qarkullimi,*
- *siguracion,*
- **taksat e mjetit,**
- *leje e transportit që lëshohet nga Bashkia,*
- *kontroll i mjetit,*
- **leje higjeno-sanitare,**
- *certifikate pronësie.*

(dokumentacioni i kërkuar të jete i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi) ”

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur mjetin e marrë me qera nga Z.Vasil Rika me targa AA806XD për të cilin në dokumentacionin shoqëruar nuk ka paraqitur pagesën për taksat e mjetit sikundër kërkuar në dokumentat e tenderit dhe gjithashtu lejen higjeno sanitare në dokumentacionin shoqëruar lëshuar në emër të pronarit të mjetit e ka për magazinë dhe jo për mjetin e transportit duke mos plotësuar pikën 2.3.3 të kritereve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

3.3 Operatori ekonomik nuk ka paraqitur taksat vendore për Bashkinë Tiranë për vitin 2018 dhe për Bashkinë Korçë për vitin 2019 duke mos plotësuar pikën 2.2.3 të kritereve të veçanta për kualifikim, kapaciteti ekonomik dhe financiar.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Gerti-1987” shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë

20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Operatori ekonomik “**Dajti Park 2007**” shpk NUIS K11507003S

4.1. Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.2** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“Operatori Ekonomik duhet të ketë ambjente të përshtatshme për tregëtimin dhe magazinimin e mallrave objekt prokurimi, në pronësi (vërtetuar me akti i pronësisë kopje e noterizuar) ose në përdorim, sipas kontratës përkatëse noteriale shoqëruar me :

- *Leje Higjeno-Sanitare*
- *Çertifikatë dezinfektimi 3D*”

Çertifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur nga shoqëria Dajti Park 2007 shpk është e vlefshme deri në datë 01.01.2020. Çertifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur në dokumentat e tenderit nuk është e vlefshme në datën e hapjes së procedurës duke mos plotësuar pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim kapaciteti teknik.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

Operatori ekonomik “**Kadra**” sh.p.k NUIS K31321008J me adrese Tirane Kamez LAKNAS Rruga Nene Tereza, Banese Private me Nr.Pasurie 180/29, Zona Kadastrale 2372.

Vlera e ofertës = **1.968.300 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e treqind) lekë pa TVSH.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Autoritetit Kontraktor, Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë** me adresë Rruga: Jeronim De Rada pranë Shkollës Teknike Ekonomike, tel: 355 42 23 3826 dhe kontakti i personit përgjegjës Alketa Gjyshi, Nr. Tel: 0682093450, e-mail: gjyshialketa@yahoo.com brenda 5 (pesë)ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **17.01.2020.**

Ankesa: Gjatë afatit Ligjor për pritjen e ankesave të shoqërive pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për Loti II “Blerje ushqime koloniale

për Konviktet e Shkollave të Mesme”, është paraqitur ankesë nga Operatori ekonomik “4 S” shpk.

Me date 25.01.2020, pasi është marrë në shqyrtim ankesa e operatorit ekonomik “4 S” shpk dhe pas verifikimit të pretendimeve të operatorit ekonomik referuar dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk ka marrë parasysh pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “4 S” shpk duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Operatori ekonomik “4 S” shpk ka marrë përgjigje për ankesën me anë të shkresës Nr.98, datë 25.01.2020. Pas kthimit të përgjigjes nga Autoriteti Kontraktor operatori ekonomik ”4 S” shpk referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datë 03.02.2020.

Pas shqyrtimit të ankesës Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit **nr. 102/2020 datë 06.03.2020**, ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “4 S” shpk dhe të lërë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt Loti II “Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme”.